

Ne 18 dhe 19 Maj 2019 QBNF organizoi kampingun e dytë fundjavor, këtë rradhë në Vlorë me grupin tjetër të familjeve Nderfetare ne kuader te zbatimit te Projektit IFATACH



Ne 18 dhe 19 Maj 2019 QBNF organizoi kampingun e dytë fundjavor, këtë rradhë në Vlorë me grupin tjetër të familjeve Nderfetare ne kuader te zbatimit te Projektit IFATACH – Interfaith Families Together Against Challenges – me mbështetje financiare 70% nga NIWANA PEACE FOUNDATION te cilet i falenderojme plot mirnjohje.

Ne Sesionin e dites se pare te ketij Forumit Familjar Nderfetar referuan perfaqesuesit e komunitetit Ortodoks dhe atij Mysliman mbi kendveshtrimet e religjoneve te tyre per familjen si baza e patjetersueshme e shoqerise dhe ura qe na bashkon fort te gjithëve ne,

Ndersa ne Sesionin e dites se dyte referuan perfaqesuesit e kishes katolike dhe aleances ungjillore.

Te pranishmit bene pyetje, evidentuan sfidat dhe ofruan sugjerime konkrete per te forcuar jo vetem bashkepunimin mes tyre por shtrirjen dhe shperndarjen e tij edhe ne qytete te tjera.

Kampingu u kompletua me vizitat ne instucionet fetare dhe historike si edhe me bashkndarje kohe dhe bashkbisedime mes tyre ne ambiente kulturore dhe ne natyre.

Gjith ky aktivitet u fiksua ne celuloid nga telekronisti i mirenjohur Lirim Abazi te cilin e falenderojm per profesionalizmin dhe perkushtimin si edhe nje ekip studentesh te gazetarise nga universiteti i Strasburgut te cilet ndoqen te gjithe aktivitetet tona pasi do pergatisin nje reportazh televiziv me te cilen do te mbrojne temen e diplomes se tyre master mbi Modelin e Harmonise fetare ne shqiperi dhe QBNF ne vecanti.

— [Qendra e Bashkëpunimit Ndër-Fetar QBNF / Facebook](#)